



EMBASSY OF THE UNITED STATES

## TIRANA • ALBANIA

### VIZAT E SHUMËLLOJSHMËRISË – (LOTARIA AMERIKANE)

[Dokumentacioni i Kërkuar për Aplikantët e Vizës së Shumëllojshmërisë]

#### LISTA E DOKUMENTACIONIT

Pasi Qendra Konsullore Kentucky (KCC) t'ju ketë njoftuar datën tuaj të takimit për intervistë, ju duhet të përgatisni dokumentet e mëposhtme, të regjistroni datën e takimit tuaj dhe t'i dërgoni dokumentet rreth dy javë përpara intervistës në Seksionin Konsullor të Ambasadës Amerikane në Tiranë me anë të një shërbimi postar të shpejtë.

**SHËNIM:** Ju duhet të bëni çdo përpjekje që t'i dërgoni dokumentet e mëposhtme në Seksionin Konsullor me postë të shpejtë dy javë përpara datës suaj të takimit (duke përfshirë **dëftesën origjinale të shkollës së mesme**, si dhe diplomën e shkollës së lartë nëse e keni mbaruar). Nëse ju nuk e keni marrë akoma Garancinë Financiare dhe taksat nga sponsori në SHBA, ju mund t'i sillni ato së bashku me vizitën mjekësore në ditën e intervistës. Dështimi për të siguruar qoftë edhe një nga dokumentet e kërkuara më poshtë do të rezultojë në moskryerjen e intervistës në ditën e caktuar dhe vonesa të gjata. Një datë e re interviste do të caktohet vetëm pasi t'i keni sjellë të gjitha dokumentet e kërkuara (*nëse do të ketë numra vizash në dispozicion*).

Vizat në dispozicion të Lotarisë Amerikane (DV) janë subjekt i kufizimeve numerike. Aplikantët e Lotarisë të cilët dëshirojnë të marrin vizë duhet të jenë të përgatitur që të veprojnë me shpejtësi duke i dorëzuar të GJITHA dokumentet në ditën e intervistës. Nëse një aplikant i Lotarisë të DV-2016 nuk i është lëshuar një vizë në muajin në të cilin atij i ishte caktuar intervista nga KCC, vizat e vëna në dispozicion të aplikantëve të Lotarisë, mund të mos jenë të garantuara për ta. Aplikantët që kërkojnë nga Seksioni Konsullor ricaktim të datës së intervistës së tyre në muaj të mëvonshëm rrezikojnë seriozisht shansin për të marrë vizë. Gjithashtu, aplikantët që paraqiten në intervistë pa i patur të gjitha dokumentet dhe formularët e kërkuar dhe që i dorëzojnë dokumentet e kërkuara në një muaj të mëvonshëm, mund të përballen me faktin që të mos ketë më numra vizash në dispozicion për ta. Numrat e vizave të Lotarisë DV për disa rajone dhe shtete mund të mbarojnë edhe më përpara afatit të fundit të Programit DV-2016, pra përpara datës 30 Shtator 2016.

#### Dokumentacioni i Kërkuar:

##### KËTË LISTË:

Vendosni një kryq (X) në kutinë përkatëse për secilin dokument që do të dorëzoni.

##### DËFTESA E PJEKURISË:

Vetëm për aplikantin kryesor:

- Dëftesa e Shkollës së Mesme dhe një fotokopje të saj; dhe
- Nëse keni kryer arsimin e lartë, Diploma e Shkollës së Lartë dhe një fotokopje e saj.

Dëftesa e Pjekurisë (ose Vërtetimi) për aplikantët që e kanë kryer shkollën e mesme në Shqipëri duhet të certifikohet nga Drejtoria Rajonale Arsimore e Rrethit, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe më pas të legalizohet/vërtetohet nga Ministria e Punëve të Jashtme e Shqipërisë. Mos e përktheni dëftesën në Anglisht.

Aplikantët që e kanë kryer shkollën jashtë Shqipërisë duhet ta legalizojnë dëftesën e

pjekurisë sipas procedurave të shtetit përkatës dhe ta përkthejnë në Anglisht dhe noterizojnë nga një noter publik i licensuar.

Aplikantët që e kanë mbaruar shkollën e mesme në Greqi të lexojnë nën paragrafin '[Dokumente të Lëshuara nga Autoritetet Greke](#)' për procedurat specifike mbi përkthimin e dokumenteve të marra nga Greqia.

- PËRKTHIMI:**  
Nuk ka nevojë për përkthim e noterizim të dokumenteve në gjuhën shqipe të lëshuara nga autoritetet shqiptare. Vetëm dokumentet që nuk janë në gjuhën Shqipe ose Angleze duhet të përkthehen në Anglisht dhe të noterizohen. Përjashtim bëjnë vendimet gjyqësore (si p.sh. të divorcit dhe ato që tregojnë një dënim), të cilat DUHEN përkthyer.
- CERTIFIKATA E LINDJES (për secilin aplikant):**  
1 (një) certifikatë lindjeje në 6 gjuhë për përdorim jashtë shtetit për secilin aplikant që ka lindur në Shqipëri. Certifikata duhet të lexojë Certifikatë Lindjeje, dhe jo Certifikatë Personale. Certifikata e lindjes duhet të jetë lëshuar nga shteti ku ka lindur aplikanti. Certifikata duhet të ketë statusin civil të tanishëm. Nëse keni lindur në Greqi, lexoni paragrafin '[Dokumente të Lëshuara nga Autoritetet Greke](#)' rreth procedurës së vulës apostille dhe përkthimit zyrtar.
- CERTIFIKATA E MARTESËS (për secilin aplikant):**  
1 (një) certifikatë martesë për secilin aplikant (nëse jeni të martuar). Certifikata duhet të përmbajë edhe mbiemrin tuaj para martesës.
- VENDIM I GJYKATËS PËR DIVORCIN APO CERTIFIKATË VDEKJEJE:**  
Nëse keni qenë të martuar më parë, përfshini prova të përfundimit të të gjitha martesave të mëparshme, qoftë për shkak të vdekjes, apo të divorcit (si p.sh. certifikatë vdekje të bashkëshortit/es, vendimi përfundimtar i divorcit i përkthyer në anglisht, etj).
- VËRTETIM I GJENDJES GJYQËSORE NGA MINISTRIA E DREJTËSISË:**  
Çdo aplikant mbi moshën 16 vjeç duhet të aplikojë për vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore (dëshmi penaliteti) tek Posta Shqiptare. Shënoni "Ambasada Amerikane" si përgjigje e pikës "Institucioni për të cilin kërkohet certifikata" të formularit të aplikimit për vërtetimin e gjendjes gjyqësore. Vërtetimi duhet t'i përfshijë të gjithë emrat dhe/apo mbiemrat e përdorur, **përfshirë mbiemrin e vajzërisë.**  
Vërtetimet e gjendjes gjyqësore të aplikantëve për Vizë Amerikane do të dërgohen direkt në Zyrën Konsullore të Ambasadës Amerikane. Vetëm vërtetimet e marra direkt nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore do të pranohen; aplikanti nuk mund të paraqesë vetë vërtetimin e gjendjes gjyqësore. Për të dëshmuar që ju keni aplikuar për dëshminë e penalitetit, duhet të dërgoni një kopje të mandatit të arkëtimit nga Posta Shqiptare.  
**Kujdes:** Shpesh aplikantët refuzohen vetëm se ata nuk kanë përfshirë **të gjithë emrat/mbiemrat e përdorur** në vërtetim.  
**SHËNIM:** Personat që janë dënuar për një vepër penale duhet të paraqesin vendimin e gjykatës të përkthyer e noterizuar, ku të tregohet dënimi, pavarësisht faktit nëse personi është falur, ka fituar amnistinë, apo është rehabilituar.
- VËRTETIM NGA POLICIA E NJË VENDI TË HUAJ:**  
1 (një) vërtetim nga Policia e një vendi të huaj për personat mbi moshën 16 vjeç, të përkthyer dhe noterizuar në Anglisht, në rastet kur jetoni aktualisht dhe keni më shumë se 6 muaj në atë vend, ose në rastet kur keni jetuar më parë më shumë se një vit. Në rastet kur keni përdorur më shumë se një emër apo mbiemër vërtetimi duhet t'i përfshijë të gjithë emrat dhe/apo mbiemrat e përdorur, përfshirë mbiemrin e vajzërisë. Për më tepër informacion, vizitoni faqen e Internetit (në Anglisht) të Departamentit Amerikan të Shtetit Byrosë së Çështjeve Konsullore "[Dokumentacioni që Aplikanti Duhet të Dërgojë në NVC](#)".

Vërtetimi i Policisë Greke: Lexoni paragrafin '[Dokumente të Lëshuara nga Autoritetet Greke](#)' për informacion të detajuar.

Kujdes: Shpesh aplikantët refuzohen vetëm se ata nuk kanë përfshirë të gjithë emrat/mbiemrat e përdorur në vërtetim.

**REGJISTRONI DATËN E TAKIMIT DHE DEGËN E DHL-SË:**

Secili aplikant i vizës, pavarësisht moshës duhet të regjistrojë datën e takimit dhe të zgjedhë degën e DHL-së ku dëshiron t'i dorëzohet pasaporta pas përfundimit të rastit tuaj, apo të dërgoni dokumente shtesë nëse do ju kërkohet nga Seksioni Konsullor. Ndiqni këta hapa: 1) krijoni një llogari tek <https://ais.usvisa-info.com/sq-al/iv>, 2) zgjidhni "Unë kam një datë takimi për intervistë në Konsullatë nga Qendra Kombëtare e Vizave (NVC), Qendra Konsullore në Kentucky (KCC) ose Seksioni Konsullor dhe jam udhëzuar që të regjistroj takimin tim në këtë faqe interneti", pastaj 3) regjistrohuni me të dhënat tuaja. Më pas 4) zgjidhni "Duhet të regjistroj një takim për vizë imigruese që NUK është për vizë "K" (të fejuari, bashkëshorti, fëmije)". 5) Vendosni të dhënat e kërkuara dhe numrin e çështjes tuaj\* dhe më pas 6) zgjidhni "Vazhdo" (me ngjyrë të gjelbër). 7) Vazhdoni me regjistrimin e korrierit të DHL-së. 8) Vazhdoni me "Përfundoni regjistrimin tuaj". 9) Printoni fletën me titull "Udhëzime" dhe dërgojeni së bashku me dokumentet e tjera. Viza juaj nuk do të lëshohet nëse nuk e sillni këtë dokument në Seksionin Konsullor.

\*Nëse gjatë regjistrimit tuaj ju merrni një mesazh të tillë: "Numri i çështjes për vizë emigruese që është dhënë nuk është gati për të caktuar një takim", lutemi prisni edhe disa ditë derisa rasti juaj të jetë ngarkuar elektronikisht në faqen e internetit më sipër. Zakonisht kjo ndodh pasi aplikanti e merr njoftimin me datën e takimit për intervistë disa ditë më përpara se dosja juaj elektronike të vijë në Seksionin Konsullor. Rrallëherë ndodh edhe që numri i çështjes suaj të jetë futur në sistem pa zerot, p.sh.: në vend të 2016EU0001234 të jetë 2016EU1234 dhe për këtë shkak ju jep mesazhin e mësipërm. Ndaj, provoni edhe këtë mundësi duke hequr zerot. Provoni të regjistroheni përsëri pas disa ditësh, por sigurohuni që të jeni regjistruar përpara datës suaj të takimit.

**FOTOGRAFIA:**

Pavarësisht nga moshja, të gjithë aplikantët e vizave emigruese për në SHBA, duhet të paraqesin dy fotografi me ngjyra, të papërpunuara me programe kompjuterike, me përmasa 5 cm x 5 cm, me sfond të bardhë. Shkruani emër, mbiemër e numrin e rastit nga prapa fotografisë. Fotografia duhet të ketë një pamje frontale, me kokën në qendër të fotografisë. Për më shumë detaje, vizitoni faqen e Internetit (në Anglisht) të Departamentit Amerikan të Shtetit Byrosë së Çështjeve Konsullore "[Kërkesat e Fotografisë](#)". Në qoftë se kërkesat nuk plotësohen, fotografia nuk do të pranohet. Fotografia duhet të jetë nxjerrë gjashtë muajt e fundit.

**VËRTETIM USHTARAK:**

1 (një) vërtetim nga Zyra e Rekrutim-Mobilizimit të Ushtrisë për të gjithë aplikantët meshkuj 18 vjeç e lart, pavarësisht nëse e keni kryer apo jo shërbimin ushtarak; si dhe për aplikantet femra që kanë kryer shërbim të mëparshëm ushtarak.

**DOKUMENTE TË TJERA CIVILE:**

1. Vendime të lëshuara nga autoriteti shtetëror përgjegjës në lidhje me ndryshimin e emrit/mbiemrit, moshës, birësimi, apo rasteve të ngjashme.
2. Certifikatë origjinale të lindjes nga vendi i huaj, i përkthyer e noterizuar. Nëse keni lindur në Greqi, lexoni paragrafin '[Dokumente të Lëshuara nga Autoritetet Greke](#)' për informacion të detajuar.

**FOTOKOPJA E PASAPORTËS:**

Një fotokopje e faqes me të dhënat biometrike, pavarësisht moshës. Pasaporta e aplikantit duhet të jetë e vlefshme për udhëtim dhe duhet të ketë të paktën një vit vlefshmëri përtej datës së lëshimit të vizës. Ju duhet të paraqisni pasaportën tuaj në datën e intervistës. Pasaporta duhet të përmbajë emrin e mbiemrin tuaj të përditësuar (p.sh.: për rastet e aplikanteve të sapomartuara).

- PROVA TË MBËSHTETJES FINANCIARE NGA SPONSORI NË SHBA:**
- [Formulari I-134](#) (Affidavit of Support) - Një garanci financiare origjinale (jo fotokopje as me e-mail) nga qytetari amerikan apo me green card. **Vini re:** pika 11 e formularit duhet plotësuar: "I intend to make specific contributions..." Ky dokument nuk duhet të jetë më i vjetër se 12 muaj kur të paraqitet në ditën e intervistës,
  - Fotokopje të pasaportës amerikane të sponsorit, të certifikatës së natyralizimit, ose fotokopje të kartës së rezidentit të përhershëm të ligjshëm,
  - Vërtetim punësimi të lëshuar kohët e fundit, i cili të përmbajë informacion se për sa kohë keni qenë të punësuar dhe rrogën tuaj,
  - Taksat e vitit të fundit (Formulari 1040), ose [një transkript apo kopje të taksave të marrë direkt nga Shërbimi i Brendshëm i të Ardhurave](#).
  - Formularët W-2 të vitit të fundit për të gjitha punët,
  - Nëse sponsori është i martuar, edhe bashkëshortja e tij duhet të dorëzojë Formularin I-134 të firmosur (origjinal, jo fotokopje, as me e-mail) shoqëruar me fotokopje të pasaportës amerikane të sponsorit, të certifikatës së natyralizimit, ose fotokopje të kartës së rezidentit të përhershëm të ligjshëm.
  - Sigurohuni që të ardhurat e sponsorit të jenë [mbi 125 përqind të nivelit të varfërisë \(poverty guideline\)](#), që vendoset çdo vit nga Departamenti Amerikan i Shërbimeve të Shëndetit dhe Njeriut, përndryshe ju duhet të gjeni një sponsor tjetër. **Kujdes:** shpesh aplikantët refuzohen për këtë arsye, gjë që mund të çojë në humbjen e numrit të vizës të vënë në dispozicion për ju në atë muaj nga KCC-ja.

- DOKUMENTE TË LËSHUARA NGA AUTORITETET GREKE:**
- Dëftesa e shkollës së mesme, certifikata e lindjes dhe vendimet gjyqësore:** duhet të kenë vulën apostille, si dhe të jenë të përkthyer në Anglisht nga [Zyra e Përkthimeve e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë](#).
  - Vërtetimi nga policia greke:** Aplikantët duhet të aplikojnë tek Zyra e e Gjendjes Gjyqësore për të Huajt (Ipiresia Pinikou Mitroou allodapon), Mesogion 96, 101 79 Athinë, Greqi, tel. (+30) 210776-7300, 210776-7185, 210776-7186, & 210776-7043. Lutemi mos kontaktoni Ambasadën Greke në Tiranë për vërtetimin e policisë greke. Vërtetimi duhet të legalizohet me vulën apostille dhe të jetë i përkthyer në Anglisht nga [Zyra e Përkthimeve e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë](#).

- VIZITA MJEKËSORE:**  
Secili aplikant, pavarësisht moshës, duhet t'i nënshtrohet vizitës mjekësore, e cila kryhet vetëm nga mjekët e autorizuar nga Seksioni Konsullor i Ambasadës Amerikane, në Tiranë. Aplikanti duhet të paraqitet për vizitën mjekësore **fiks tre javë përpara datës** së intervistës.

Përpara takimit me mjekun, ju duhet të shkarkoni e të lexoni me kujdes listën e [Udhëzimeve Mjekësore](#), ta plotësoni atë dhe t'ia paraqisni mjekut të autorizuar së bashku me një kopje të fletës së takimit për vizë. Aplikanti është gjithashtu përgjegjës për pagesën e tarifës së ekzaminimit nga mjekët.

**Mos e sillni CD-në e Rrezeve X në Seksionin Konsullor.** Lexoni më poshtë nën Paragrafin "Pasi të Keni Marrë Pasaportën dhe Paketën e Vizës" të këtij udhëzimi në lidhje me CD-në e rrezeve X.

Formularin e Vizitës Mjekësore mund ta gjeni në faqen e Internetit (në Anglisht) të Departamentit Amerikan të Shtetit Byrosë së Çështjeve Konsullore "[Përgatitja për Intervistë – Vizita Mjekësore](#)". Kërkoni për TIA –Tirana dhe ju do të shkarkoni formularin e vizitës mjekësore.

**Shënim:** Data e skadimit të vizës suaj do të kushtëzohet nga data e skadimit të raportit mjekësor. Formularët mjekësorë të klasifikuar si Class B (TB) janë të vlefshme për 3 muaj nga data që e firmos mjeku. Të gjithë formularët e tjerë të klasifikuar si "Nuk ka sëmundje të dukshme" janë të vlefshëm për 6 muaj nga data që e firmos mjeku. Nëse rasti juaj kalon për proces administrativ të mëtejshëm, apo shqyrtimi i rastit tuaj vonohet për shkak të dokumenteve që mungojnë, raporti mjekësor mund të skadojë përpara se viza të lëshohet. Në këtë rast, juve do ju kërkohet të kryeni edhe njëherë vizitën mjekësore dhe ta dërgoni zarfin mjekësor në Seksionin Konsullor përpara se ju të merrni vizën tuaj.

- PROVA TË LIDHJES SUAJ** (për çiftet e sapomartuar):  
Fakte dhe prova që tregojnë lidhjen tuaj si p.sh. fotografi, korrespondencë, telefonata, që tregojnë qartazi aplikantët e vizës; ose prova të tjera që tregojnë lidhjen tuaj përgjatë kohës. USB-të apo DVD-të NUK pranohen dhe do të asgjësohen nëse i dërgoni.
- SKADIMI I DOKUMENTEVE:**  
Të gjitha dokumentet duhet të jenë marrë nga zyrat përkatëse jo më parë se një vit nga data e intervistës. Përndryshe, rasti juaj do të refuzohet derisa ju të sillni dokumentet e përditësuar.

---

## Shqyrtimi i Vizave të Shumëllojshmërisë

Data juaj e takimit caktohet nga Qendra Kombëtare në Kentucky (KCC), SHBA. Ju do të njoftoheni për datën tuaj të intervistës duke vendosur numrin tuaj të konfirmimit në Kontrollin e Statusit të Regjistrimit në [www.dvlottery.state.gov](http://www.dvlottery.state.gov). Vetëm pasi ju të jeni përzgjedhur, pasi t'u jeni përgjigjur udhëzimeve të njoftimit të mundësuar për ju nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Aplikimit, si dhe pasi të ketë filluar procesimi i rastit tuaj, vetëm atëherë ju mund të merrni në vazhdim e-maile komunikimi nga KCC-ja që ju njofton juve të vizitoni Kontrollin e Statusit të Aplikimit për informacione të reja rreth aplikimit tuaj, si dhe për datën tuaj të intervistës. Bëni kujdes të mos bini pre e mesazheve mashtruese që mund t'ju kërkojnë para. KCC-ja **nuk** do të kërkojë nga ju t'u dërgoni para (të holla) atyre, kësaj Ambasade, apo ndonjë Ambasade tjetër të SHBA-së me postë, apo shërbime të tilla si Western Union. Pagesa e vetme bëhet në Seksionin Konsullor, në ditën e intervistës. Për më tepër informacion, lutemi të vizitoni faqen tonë të internetit "[Kujdes nga Mashtrimi](#)".

Informacion të detajuar në Anglisht rreth Udhëzimeve për të Përzgjedhurit për Programin e Vizave të Shumëllojshmërisë, ju mund ta gjeni në faqen e Internetit (në Anglisht) të Departamentit Amerikan të Shtetit Byrosë së Çështjeve Konsullore "[Udhëzimet për të Përzgjedhurit](#)".

## Para Intervistës

**APLIKANTI PËR VIZË** duhet të lexojë [Informacionin për të Drejtat Ligjore në dispozicion të Imigrantëve Viktima të Dhunës Familjare](#) (PDF 137.20 KB) në Shtetet e Bashkuara dhe Fakte rreth Imigrimit bazuar në Vizën e Martesës.

**SIGURIA:** Pajisjet elektronike të çfarëdo lloji nuk lejohen brenda Ambasadës Amerikane, duke përfshirë telefonat celularë, kamera, pajisje regjistrimi, elektronike, kompjuter, çanta apo bagazh. Aplikantët nuk mund të sjellin armë, lëngje apo objekte nën presion (të tilla si Hairspray ose deodorant).

## Intervista

**TARIFA E APLIKIMIT:** Ju do të kryeni pagesën në ditën e intervistës tek arkëtari i Seksionit Konsullor. Pagesa kryhet vetëm me para në dorë tek arkëtari i Konsullatës në Dollarë Amerikanë ose Lekë dhe është e pakthyeshme.

Duke filluar nga data 13 Prill 2012, ju duhet të paguani **330 Dollarë** ose ekuivalentin në Lekë për çdo person, pavarësisht nga mosha. Kjo pagesë kryhet **vetëm** tek arkëtari i Seksionit Konsullor të Ambasadës Amerikane në Tiranë. Vini re që këto tarifa janë subjekt i një ndryshimi të mundshëm në kohë, ndaj informacioni më i përditësuar për pagesën ndodhet në faqen e Internetit (në Anglisht) të Departamentit Amerikan të Shtetit Byrosë së Çështjeve Konsullore "[Tarifat për Shërbimet e Vizave](#)".

Ju mund të shikoni statusin e rastit të vizës tuaj (në Anglisht) në: <https://ceac.state.gov/CEAC/>. Çfarë ju duhet juve është numri i rastit tuaj dhe vendi ku është kryer intervista (p.sh. Tiranë), për të monitoruar progresin e rastit tuaj.

## Pas Intervistës

Pas intervistës suaj me Oficerin Konsullor, nëse dosja juaj është e plotë dhe ju të gjendeni të kualifikuar për vizën, viza juaj do të lëshohet dhe do t'ju dërgohet së bashku me paketën e vizës me anë të shërbimit postar DHL në zyrën që ju keni zgjedhur kur u regjistruat për këtë shërbim. Ju do të njoftoheni nga DHL-ja me e-mail për të tërhequr pasaportën dhe paketën e vizës suaj të emigrimit. E rëndësishme: Ju lutemi **mos e hapni zarfin e vulosur nga Ambasada** që ka paketën e vizës së emigrimit, përndryshe ai zarf bëhet i pavlefshëm.

*Shënim:* nëse ju nuk e keni marrë pasaportën me vizë brenda 15 ditëve pune nga data kur është dorëzuar tek ne për lëshimin e vizës, ju mund të kontaktoni zyrën tonë në [TiranaUSConsulate@state.gov](mailto:TiranaUSConsulate@state.gov)

---

Ky dokument gjendet në: <http://albanian.tirana.usembassy.gov/dv.html>



Disa raste të aplikimeve për vizë mund të kërkojnë: a) dokumente shtesë, ose b) [proces të mëtejshëm administrativ](#).

- a) Kur ju kërkohen dokumente shtesë, Oficeri Konsullor do ju japë një fletë refuzimi ku shpjegohen dokumentet e kërkuara. Pikat e shënuara me kryq aplikohen për rastin tuaj. Vini re që në atë letër Oficeri Konsullor, përveç gjuhës shqipe ku renditen dokumentet e kërkuara nga ju, mund të përdorë edhe gjuhën angleze për të shpjeguar dokumentet e kërkuara nga sponsori në SHBA. Ndaj, ju duhet t'ia dërgoni një kopje të letres së refuzimit me faks apo email petitionerit në SHBA. Këshillohet që t'i dërgoni të gjitha dokumentet e kërkuara njëherazi, pasi dërgimi i dokumenteve jo të plota do të vonojë rastin tuaj.
- b) Procesi i mëtejshëm administrativ kërkon kohë shtesë pas intervistimit së aplikantit nga Oficeri Konsullor. Aplikantëve u bëhet me dije kjo kërkesë ditën kur ata aplikojnë. Shumica e proceseve administrative zgjidhet brenda 60 ditëve nga data e intervistës. Përpara se të kontaktojnë Zyrën Konsullore rreth statusit të procesit administrativ, aplikantët apo përfaqësuesit e tyre do të duhet të presin të paktën 60 ditë nga data e intervistës, apo nga data e dorëzimit të dokumenteve shtesë, në varësi se cila datë është më vonë. Nëse një proces administrativ është i nevojshëm, kohëzgjatja mund të ndryshojë sipas rrethanave individuale të çdo rasti.

## Në Rastet e Rralla kur ju nuk Keni Marrë dot Udhëzimet nga KCC-ja

Dokumentacioni i kërkuar, përveç dokumentacionit të mësipërm, është: **FORMULARI Elektronik i Vizës Emigruese DS-260**, i cili duhet plotësuar në të gjitha pikat në Anglisht. Mos lini asnjë pyetje pa plotësuar. Pyetjeve që nuk aplikohen për rastin e aplikantit duhet t'i përgjigjeni me "Does Not Apply". Ky formular gjendet në faqen e Internetit (në Anglisht) të Departamentit Amerikan të Shtetit, Byrosë së Çështjeve Konsullore "[Formularë të Aplikimit për Viza](#)". Për më shumë informacion, kontaktoni [KCCDV@state.gov](mailto:KCCDV@state.gov).

## Shumë e Rëndësishme

Asnjë lloj garancie nuk mund t'ju jepet paraprakisht lidhur me lëshimin e vizës. Vetëm oficeri konsullor mund të marrë një vendim pasi të ketë shqyrtuar të gjithë aplikimin tuaj zyrtar dhe t'ju ketë intervistuar personalisht.

Ju këshillojmë që të mos të mos shisni shtëpinë, makinën apo pronën, të mos lini punën dhe të mos blini biletën derisa të keni marrë në dorë pasaportën me vizë. Kjo zyrë do të bëjë çdo përpjekje që të përshejtojë procesin. Gjithsesi, nëse do të jetë e nevojshme, aplikantëve mund t'u kërkohet të kthehen në Seksionin Konsullor edhe një herë, apo të dërgojnë informacion apo dokumentacion shtesë me postë.

Për aplikantët e Lotarisë DV, afati i fundit i lëshimit të vizës është data 30 shtator e vitit fiskal. Për shkak të numrit të kufizuar të vizave që mund të lëshohen nga ky program, mund të ndodhë që vizat të mos jenë të disponueshme edhe përpara kësaj date. Kjo është veçanërisht e vërtetë për aplikimet që kryhen apo procesohen sa më afër datës 30 shtator. (Për shembull: Personat e zgjedhur për programin e lotarisë DV-2016 kanë të drejtë të aplikojnë për lëshimin e vizave vetëm gjatë vitit fiskal 2016, nga 1 tetori 2015 deri më 30 shtator 2016. Aplikantët duhet të pajisen me vizën e tyre ose të përshtasin statusin deri para fundit të vitit fiskal. Nuk përfitojnë asnjë shtyrje të lotarisë për vitin e ardhshëm personat që janë përzgjedhur, por që nuk janë pajisur me vizë deri më 30 shtator 2016 [fundi i vitit fiskal]).

## Aprovimi i Vizës - Pasi të Keni Marrë Vizën

**Pasaporta me Vizë** – Viza juaj emigruese do vendoset në pasaportën tuaj. Kontrolloni të dhënat tuaja në vizë për ndonjë pasaktësi të mundshme. Nëse vëreni ndonjë gabim në vizë, duhet të kontaktoni Seksionin Konsullor me anë të emailit në [TiranaUSConsulate@state.gov](mailto:TiranaUSConsulate@state.gov), ku të shpjegoni gabimin në vizë.

**Paketa Emigruese e Vulosur (zarfi ngjyrë kafe)** – Ju do të merrni gjithashtu një zarf të vulosur, i cili ka dokumentacionin tuaj, dhe që ju do e dorëzoni personelit të Doganave dhe Mbrojtjes së Kufijve të SHBA-së në pikën e hyrjes (në aeroport) sapo të mbërrini në SHBA. Ju NUK duhet ta hapni zarfin e vulosur nga Ambasada që mban paketën tuaj të emigrimit. Ky zarf duhet të mbahet në një bagazh dore së bashku me CD-në e rrezeve X.

**Tarifa e Pagesës së Vizës Emigruese për Shërbimet e Shtetësisë dhe Emigracionit të Shteteve të Bashkuara (USCIS)** - Duke filluar nga data 1 Shkurt 2013, secili individ, të cilit i është lëshuar një vizë emigruese për në SH.B.A., do të **duhet të paguajë tarifën e Vizës së Emigrimit për Shërbimet e Shtetësisë dhe Emigracionit të Shteteve të Bashkuara (USCIS) prej 165 Dollarësh Amerikanë përpara se të udhëtojë për në SHBA**. Në zarfin e DHL mbi paketën e vizës ju do të merrni udhëzimet e duhura se si të kryeni pagesën. [Faqja e internetit të USCIS](#) (në Anglisht) ka më tepër detaje për tarifën e re, përfshirë edhe informacion

kontakti për USCIS, nëse keni pyetje të mëtejshme. **Njoftim i Rëndësishëm:** USCIS nuk do të lëshojë Green Card derisa ju të keni paguar këtë tarifë.

**Kur Duhet të Udhëtoni** – Ju duhet të mbërrini dhe të aplikoni për praninë në SHBA përpara se të skadojë viza juaj, pasi ju mund të humbisni statusin tuaj. Viza në pasaportë është zakonisht e vlefshme për rreth 6 muaj, përveç rasteve kur vizita mjekësore skadon më shpejt, e cila bën që edhe viza të kufizohet sipas datës së skadimit të vizitës mjekësore. Viza juaj nuk mund të shtyhet përtej datës së skadimit dhe tarifat e paguara për të janë të pakthyeshme. Nëse për çfarëdo arsye ju nuk mund ta përdorni vizën, ju lutemi kthejeni atë në konsullatë. Mos dilni nga SHBA pa marrë më parë Green Card.

**Udhëtimi për në SHBA** – Kur të udhëtoni për në SHBA, aplikanti kryesor duhet të hyjë ose përpara ose në të njëjtën kohë me anëtarët e tjerë të familjes (pra, anëtarët e familjes, të cilëve u është lëshuar një vizë bazuar në rastin e aplikantit kryesor, nuk udhëtojnë dot përpara aplikantit kryesor). Fëmijët që mbushin 21 vjeç pas datës së intervistës duhet të hyjnë në Shtetet e Bashkuara përpara se të mbushin moshën, [në të kundërt humbasin statusin](#). Me vizën tuaj (të paskaduar) dhe paketën e vizës, ju do të udhëtoni dhe mbërrini në pikën e hyrjes (zakonisht aeroport) dhe do të kërkonit leje për të hyrë në SHBA.

**Formulari I-551**, Karta e Banorit të Përhershëm, apo Karta Jeshile, do të postohet në adresë në SHBA që ju keni paraqitur në dokumente gjatë intervistës. Ky është një dokument shumë i rëndësishëm, që do të shërbejë për të vërtetuar që ju keni leje për banim të përhershëm dhe ju jep mundësinë të qëndroni dhe hyni në SHBA pa vizë. Lexoni më poshtë paragrafin "Mirësevini në Amerikë" për më shumë informacion.

**Vaksinat:** Fëmijët janë të detyruar të kenë disa vakcina të kryera përpara se të mund të regjistrohen në shkollë. Ndaj rekomandohet të keni me vete kopjen e vaksinave që ju dha mjeku gjatë vizitës mjekësore. Mësoni rreth kërkesave për vakcina të kërkuara sipas shteteve në faqen e internetit të [Qendrës për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve](#) të Departamentit të Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore.

#### **PËR EMIGRANTËT E RINJ: MIRËSEVINI NË AMERIKË**

Lutemi të vizitoni udhëzimet në faqen e Internetit (në Anglisht) të Shërbimeve Amerikane të Qytetarisë dhe Emigracionit (USCIS) "[Mirësevini në Shtetet e Bashkuara: Një Guidë për Emigrantët e Rinj](#)" dhe në adresën [Welcome To USA](#).

Pasi t'ju jetë lëshuar Karta juaj e Rezidentit të Përhershëm, në përgjithësi ju duhet të qëndroni jashtë SHBA-së **më pak sesa një vit**, përndryshe do të humbisni statusin e Rezidentit të Përhershëm Ligjor. Për më tepër informacion rreth të drejtave dhe përgjegjësisë të Rezidentëve të Përhershëm Ligjorë (ose me Green Card), lexoni në Anglisht në faqen e internetit të USCIS: [Ruajtja e Statusit të Rezidentit të Përhershëm](#), si dhe udhëzuesin e USCIS, në Anglisht: "[Unë jam një Banor i Përhershëm. Si të Marr Vesh... Cilat Janë Përgjegjësitë e Mia?](#)" (PDF 1.19 MB), dhe "[Si të Marr një Leje Rihyrëse?](#)" (PDF 1.18 MB).

Nëse keni pyetje lidhur me kartën ose nuk e merrni atë brenda një periudhe të caktuar, ju lutemi të kontaktoni me [zyrën e USCIS](#) pranë shtetit ku banoni në SHBA.



#### **PARALAJMËRIM**

**MASHTRIMI ME VIZAT ËSHTË NJË KRIM I RËNDË. PËRPJEKJET PËR TË KEQPREZANTUAR NJË FAKT MATERIAL, APO PËR TË MASHTRUAR OFICERIN KONSULLOR, MUND TË RREZIKOJNË APLIKIMIN AKTUAL APO TË ARDHSHËM PËR VIZË.**

**VËRTETIM:** Me anë të kësaj unë vërtetoj se i kam lexuar udhëzimet e mësipërme dhe që e kam të gjithë dokumentacionin e shënuar me "X" dhe jam i përgatitur për të paraqitur ato në kohën e intervistës (ose që i kam dërguar me anë të DHL-së mbi dy javë para datës së intervistës) së bashku me këtë listë udhëzimesh.

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi i Aplikantit)

\_\_\_\_\_  
(Data)

\_\_\_\_\_  
(Emri i Aplikantit)